

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI / KOMUNËSKUPITINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/2021 Nr. i faq./Dr.sht./No.pg 1
Data/Datum/Date 20.01.2021



RAPORT I KUVENDIT KOMUNAL TË RAHOVECIT

(JANAR- DHJETOR 2021)

2021

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
QËLLIMI I RAPORTIT	2
FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT	3
KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS	3
KOMITETI PËR KOMUNITETE.....	4
KOMITETET KONSULTATIVE	5
MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE.....	5
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA	17
DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2021	18
MONITORIMI I MBLEDHJEVE.....	21
RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS	21
NJOFTIMET PËR MBLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLËSE.....	22
ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KUVEND- AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS	22
PUBLIKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT	23
SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE	23
RISHQYRTIMI I AKTEVE LIGJORE TË EVIDENTUARA.....	24
PËRFUNDIM	24

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

HYRJE

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit përgjatë periudhës janar- dhjetor 2021.

Në sistemin e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, komuna është njësia themelore e vetëqeverisjes me ç' rast i gjithë territori i Kosovës është i ndarë në 38 komuna.

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë organet kryesore të komunës dhe që të dyja zgjedhën veç e veç dhe me vota të drejtpërdrejta të qytetarëve të komunës, të cilat janë obliguara të ushtrojnë kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparente dhe llogaridhënien e organeve të komunës si dhe garanton një kontroll të ndërsjellë ndërmjet organeve komunale.

Në kuadër të organeve të Komunës së Rahovecit, Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Planin e Punës së Kuvendit të Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit.

QËLLIMI I RAPORTIT

Përmes këtij raporti jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre. Ky raport ka për qëllim që të rrit transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Kuvendi i Komunës së Rahovecit është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, dhe Planit të Punës së Kuvendit të Komunës. Kuvendi duhet të mbajë së paku 10 mbledhje në vit, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës ka komitetet obligative sic janë:

- Komiteti për Politikë dhe Financa,
- Komiteti për Komunitete si dhe
- Komitetet konsultative ndihmëse të cilat kanë për qëllim shqyrtimin e hollësishëm të politikave, dokumenteve strategjike, vendimeve dhe rregulloreve të komunës nga njëra anë, si dhe mbikqyrjen e veprimtarive të degës ekzekutive në anën tjetër.

Andaj, Kuvendi i Komunës, themelon komitete të posaçme, të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre kompetencave.

Komitetet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit të themeluara në vitin 2021

- Komiteti për Politikë dhe Financa (i përhershëm)
- Komiteti i Komuniteteve (i përhershëm)
- Komitetet Konsultative.

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Komiteti për Politikë dhe Financa është organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Kështu, Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

- Të gjitha politikave,
- Dokumenteve fiskale dhe financiare,
- Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,
- Kornizës vjetore buxhetore afatmesme,
- Planit vjetor të prokurimit,
- Rregullores vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat,
- Planit vjetor të punës për auditimin e brendshëm,
- Planit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe
- Marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal.

Komiteti për Politikë dhe Financa, gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur një performancë të mirë duke e përmbushur obligimin e tij ligjor, që të mbajë takimet e rregullta, por edhe të trajtojë të gjitha dokumentet e rëndësishme para se ato të kalojnë për diskutim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje për periudhën: janar –nëntor, gjatë këtyre seancave ka diskutuar pika të ndryshme duke qenë në kompetencë të saj, ajo ka diskutuar dhe ka rekomanduar Kuvendit për të gjitha çështjet që i ka pasur në rend të ditës.

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Komiteti për Komunitete është komiteti i dytë obligativ i Kuvendit të Komunës, detyrë e të cilit është:

- Shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim.
- Shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- I rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

Komiteti për Komunitete si komitet i përhershëm në këtë dymbëdhjetëmujor ka vepruar në mënyrë të rregullt dhe në përbërje të plotë, dhe gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsej gjashtë (5) mbledhje të rregullta.

KOMITETET KONSULTATIVE

Komitetet Konsultative - Kuvendi i Komunës themelon komitete konsultative apo këshillëdhënës sektorial me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimarrjes në komunë. Në Komunën tonë është i themeluar Komiteti për Komiteti për Auditim të Brendshëm, kurse Komitetet tjera konsultative në vitin 2021 nuk janë themeluar.

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar rregullat e mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku dhjetë (10) seancave në vit të Kuvendit të Komunës, ku pesë mbledhje duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë dhe pesë mbledhje në gjashtëmujorin e dytë.

Bazuar në këtë, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 43.2 të LVL-ës, ku në periudhën janar- dhjetor 2021 ka mbajtur:

- **11 (dymbëmbëdhjetë) mbledhje të rregullta;**
- **1 (një) mbledhje solemne është mbajtur më datë 17 shkurt, me rastin e shënimit të 13 Vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;**
- **1 (një) mbledhje Inaguruese me datën 03.12.2021, me rastin e betimit të kuvendarëve të rinjë;**
- **2 (dy) mbledhje për zgjedhjen e kryesuesit të ri, me datë 13.12.2021 dhe 22.12.2021 dhe**
- **1 (një) mbledhje urgjente, për zgjedhje të kryesuesit të ri, me datën 22.12.2021**

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve. Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, komitetet shqyrtojnë agjendën nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim-akteve. Vlen të theksohet se në të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal Rahovec, ka qenë prezent, Kryetari i Komunës së Rahovecit dhe drejtorët e drejtorive komunale.

MBLEDHJET E KUVENDIT

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë e punimeve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për periudhën një veçare. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe lloji i mbledhjeve për periudhën janar-dhjetor 2021.

Seancat e Kuvendit Komunal	Seanca të rregullta	Seanca të jashtëzakonshme	Seanca tjera(solemne)	Nr. i seancave për muaj	Pika në rend dite
Janar	1		1	1	8
Shkurt	1			2	15
Mars	1			1	13
Prill	1			1	10
Maj	1			1	13
Qershor	1		1	2	8
Korrik	1	1	1	3	6
Gusht	1			1	5
Shtator	1			1	7
Tetor	1			1	4
Nëntor	1			1	5
Dhjetor	1			4	7
Gjithsesj:	12	1	3	16	101 pika të rendit të ditës

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

Në vijim të këtij Raporti po ju sjellim të gjitha vendimet, rregulloret dhe planet e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit në periudhën janar – nëntor 2021:

Nr	Emri i Vendimit	E. Rregullores	E. Planit	E. Raportit	E. Informatës	Dt. Aprovimit
1	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës në Pastaselë	Rregullore për përkujdesjen dhe Mbrojtje të Fëmijës		Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020	Informatë rreth punës së KKSB-së për gjashtë (6) mbledhjet e vitit 2020	29.01.2021
2	Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021	Rregullore për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale		Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020		26.02.2021
3	Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave			Raporti i punës i Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2020		26.02.2021
4	Vendim për lirim nga qiraja mujore për shfrytëzuesit e pronës komunale dhe lokaleve afariste për vitin 2021				Informatë për zonën e mbrojtur “Kanioni i Drinit të Bardhë tek Ura e Fshenjtë	26.02.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

5	Vendim për lirim nga taksa komunale për biznese për vitin 2021					26.02.2021
6	Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për emërtimin e rrugëve shesheve dhe lagjeve					26.02.2021
7	Vendim për shfuqizimin e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik në Pastaselë					26.02.2021
8	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës në Rahovec					26.02.2021
9	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Zoçishtë	Rregullore për organizimin funksionimin dhe bashkëpunim in me fshatrat dhe lagjet urbane			Informatë rreth formimit të komisioneve lidhur me pasuritë e komunës se Rahovecit	29.03.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

10	Vendim për këmbimin e pronës komunale me pronën private në Rahovec - Agronimi				Informatë mbi pronat të cilat gjenden në zonën e mbrojtur të Kanioni i Drinit të Bardhe tek Ura e Fshejtë	29.03.2021
11	Vendim për miratimin e Planit Lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta.				Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre	29.03.2021
12	Vendim për miratimin e Planit Lokal për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme					29.03.2021
13	Vendim për subvencionimin e lindjeve në Komunën e Rahovecit.					29.03.2021
14	Vendim i Kuvendit- Për vënien në debat publik të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të Pronës komunale					29.03.2021
15	Vendim për transferin e			Shqyrtimi i raportit	Informatë nga DSHPS-ja rreth	

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

	mjeteve vetanake			financiar janar-mars 2021	pandemisë Covid-19	29.04.2021
16	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale - Çifllak - P- 00251-0			Shqyrtimi i Raportit vjetor të Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2020	Informatë nga DBPZHR-së për periudhën janar - prill - 2021	29.04.2021
17	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale - Przhina - P - 05864-0					29.04.2021
18	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale - Rahovec P - 02352-0					29.04.2021
19	Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale - Shtavica - P - 07111-1					29.04.2021
20	Vendim për konsultim publik të Draft strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021-	Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një				29.04.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

	2025	vit të pronës së paluajtshme të Komunës;				
21	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër - 1	Plotësim ndryshimi i rregullores për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës se Rahovecit 01 Nr. 2558, të datës 27.06.2014				28.05.2021
22	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër - 2					28.05.2021
23	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër - 3					28.05.2021
24	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër - 4					28.05.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

25	Vendim Për këmbimin e pronës komunale me pronën private në Ratkoc					28.05.2021
26	Vendim - Plotësimi dhe ndryshimi për miratimin e Planit Lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore					28.05.2021
27	Vendim - Plotësimi dhe ndryshimi për miratimin e Planit Lokal për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme					28.05.2021
28	Vendim për vënien në debat publik të Draft Statutit për QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec			Shqyrtimi i Raportit të punës se Kryetarit të Komunës për 6- mujorin e parë të vitit 2021		29.06.2021
29	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Krushë të Madhe për rregullimin e			Shqyrtimi i Raportit të performancës komunale për vitin 2020		29.06.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

	parkut					
30	Vendim për Shpalljen Qytetar Nderi i Komunës së Rahovecit z Qemajl Minxhozi			Shqyrtimi i Raportit financiar Janar – Qershor 2021		30.07.2021
31				Shqyrtimi i Raportit të auditimit të jashtëm të Komunës së Rahovecit për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2020		30.07.2021
32				Shqyrtimi i Raportit të DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2020 – 2021		30.07.2021
33	Vendim për ri-destinim të mjeteve buxhetore për vitin 2021				Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike ne Komunën e Rahovecit	31.08.2021
34	Vendim për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.276/2009, të datës 02.07.2010					31.08.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

35	Vendim për lirim nga pagesa e qirasë dhe taksa komunale për personat fizik dhe personat juridik				Informatë nga DKA-ja për përgatitjen e fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022	16.09.2021
36	Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022				Informatë nga DSHPS-ja rreth situatës me Covid-19 në Komunën e Rahovecit	16.09.2021
37	Vendim për miratimin e buxhetit për vitin 2022				Informatë nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm për përkrahjen e bizneseve në qira dhe taksa afariste komunale	16.09.2021
38				Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën janar – shtator 2021	Informatë për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021	29.10.2021
39	Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Draft Planit të punë të Kuvendit të Komunës për vitin 2022					22.11.2021
40	Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Draft Planit të					22.11.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

	punë të Kryetarit të Komunës për vitin 2022					
41	Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratimin e Draft Planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022					22.11.2021
42	Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit Komunal Rahovec					13.12.2021
40	Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit Komunal Rahovec					22.12.2021

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

Në vijim të raportit do të gjeni edhe fotografi të realizuara gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal – Rahovec.



KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej dymbëdhjetë (11) mbledhje për periudhën: janar – nëntor 2021.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Komitetin për Politikë dhe Financa të Komunës së Rahovecit për periudhën janar – nëntor të vitit 2021. Në tabelë janë të paraqitura numri i mbledhjeve të mbajtura dhe pikat e rendit të ditës për periudhën janar- nëntor 2021.

Seancat e Kuvendit Komunal	Mbledhjet e KPF-së	Pika në rend dite
Janar	1	8
Shkurt	1	8
Mars	1	13
Prill	1	10
Maj	1	11
Qershor	1	7
Korrik	1	5
Gusht	1	4
Shtator	1	6
Tetor	1	4
Nëntor	1	5
Dhjetor	0	0
Gjithsesj:	12	81 pika të rendit të ditës

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

Fotografi të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të kryesura nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal Rahovec z. Afrim Dina.



DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2021

Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen konsultime publike në lagje dhe fshatra. Arsyeja pse është përzgjedhur ky zotim është që të fuqizohet qeverisja e mirë, bazë e së cilës është pjesëmarrja qytetare në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin, për një qeverisje gjithëpërfshirëse.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimit të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e sheh të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore, dhe detajon procedurat për mbarrëvajtjen e tyre.

Në bazë të nenit 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 61 paragrafi 2 Të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, neni 17, 18 pika 1.7 dhe 19 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa,

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

organizojnë dëgjime publike rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2021.

INFORMIMI RRETH MBAJTJES SË DËGJIMEVE BUXHETORE

Një nga sfidat kryesore të dëgjimeve buxhetore është mënyra e informimit të qytetarëve. UA për transparencë i obligon komunat që paralajmërimin e publikut për mbajtje të takimeve publike ta bëjnë përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës 14 ditë para mbajtjes së dëgjimit. Komuna e Rahovecit ka bërë njoftimin për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 14 ditë para mbajtjes së takimeve pikërisht më datë 09 qershor 2021, përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës. Njoftimi ka përfshirë informata si data, koha dhe vendi i takimit, publikuar njoftimi, njoftimin mund ta gjeni në këtë vegëz

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-projekt-buxhetin-e-komunes-per-vitin-vijues-2022/>

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, z.Afrim Dina ka përgatitur kalendarin e dëgjimeve publike me qytetar për buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2022, në kuadër të këtij kalendari janë paraparë që të mbahen 10 (dhjetë) dëgjime publike me qytetarë. Dëgjimet publike me qytetarë, janë paraparë të fillojnë nga data 5 korrik 2021 dhe kanë përfunduar më datë 15 korrik 2021, janë mbajtur gjithsej 10 (dhjetë) dëgjime publike me qytetarë ashtu siç edhe ishte e paraparë me kalendarin e dëgjimeve publike, kalendarin mund ta gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/?s=kalendar+i+degjimeve+publike>

Dëgjimet buxhetore janë mbajtur në të gjitha vendbanimet, duke përfshirë edhe lagjet urbane në qytetin e Rahovecit, përpos Lagjes së Epërme dhe fshatit Hoçë e Madhe ku banon komuniteti jo shumicë, arsyeja është mos interesimi i banorëve.

Dëgjimet publike publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2022, janë përcjellur edhe nga Zyra e Kuvendit Komunal Rahovec, si dhe Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, nga zyrtari për informim çdo ditë pas mbajtjes së dëgjimit publik në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit, janë publikuar të dhënat e mbajtjes së dëgjimeve me fotografi dhe të dhëna tjera të nevojshme.

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

Gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2022 Komiteti për Politikë dhe Financa i kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Afrim Dina, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani kanë përcjellur vazhdimisht ecurinë e dëgjimeve publike me qytetarë të Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin 2022, Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht pothuajse të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, posaçërisht, dhe Kuvendi i Komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si buxheti komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit dhe i jep rekomandimet për veprime Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës duke marrë parasysh edhe rekomandimet nga komiteti për politikë dhe financa, do të shqyrtojë, dhe në rast pajtimi, të miratojë, dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale.

Dëgjimet publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2022, në secilin lokalitet janë udhëhequr nga Kryesuesi i KK-Rahovec z.Afrim Dina, pasuar më pas nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani i cili në secilin dëgjim të mbajtur ofroi informacionet e nevojshme lidhur me ndarjen e kategorive të buxhetit në ; Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale, Subvencione e transfere dhe Investime Kapitale, të pranishmit në secilin dëgjim publik të mbajtur patën mundësi të informoheshin nga drejtori i DBF-së edhe për totalin e buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2022 e që në tërësi është: **15,053,660.00€**.

Kontribut të madh në dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2022, patjetër që kanë dhënë edhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, z.Rasim Fazliu, z.Dervish Cadraku, z.Fehmi Cena, znj.Fahrije Lushi- Morina, znj. Florida Bajraktari dhe znjsh.Fjolla Duraku të cilët gjatë gjithë kohës kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e tyre karshi qytetarëve të Komunës së Rahovecit për të dëgjuar dhe marrë kërkesat, prioritetet, nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve të secilit lokalitet të Komunës së Rahovecit.

Pjesëmarrës në dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2022 ka qenë edhe drejtori për buxhet dhe Financa z. Afrim Limani, i cili pati mundësi të dëgjojnë kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve të Komunës së Rahovecit për vitin 2021, po ashtu në rast nevojë për sqarime

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

shtesë në lidhur me ndonjë çështje që i prekupon qytetarët tanë shprehën gatishmërinë për dhënien e sqarimeve të kërkuara nga ana e tyre.

Fotografi të realizuara gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për vitin 2021



MONITORIMI I MBLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve edhe gjatë këtij viti ka qenë i vazhdueshëm, puna dhe angazhimi ynë është monitoruar nga OSBE-ja, KFOR-i, OJQ-të lokale si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën, aktivitetet dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve tona. Gjithashtu, mbledhjet e Kuvendit Komunal Rahovec, janë regjistruar (xhiruar) rregullisht dhe janë transmetuar online për qytetarët e Komunës së Rahovecit.

RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Sistemi i qeverisjes lokale është një njësi e gjerë e cila përfshin edhe bashkëpunimin në mes të Ekzekutivit të komunës dhe Kuvendit me qëllim të realizimit të politikave publike në dobi të qytetarëve. Për këtë qëllim, mbikëqyrja dhe raportimi përbëjnë një proces mjaft të rëndësishëm të qeverisjes lokale, përmes të cilit mundësohet përcjellja sistematike e ngjarjeve dhe

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

aktiviteteve brenda komunës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Rahovecit i paraqet me shkrim raportet në Kuvendin e Komunës. Formë tjetër e raportimit është edhe ajo verbale, ku anëtarët e Kuvendit parashtrojnë pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim, varësisht nga natyra e çështjes. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së Ekzekutivit para Kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje.

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLËSE

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës, Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, Rregullores së Punës së Kuvendit për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, edhe për mbledhjet e të gjitha komiteteve të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit janë njoftuar me kohë, shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, përmes shpalljes së njoftimeve publike në vendet e frekuentuara, si dhe përmes faqes zyrtare të komunës në internet.

Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes është respektuar Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Njoftimet dhe materialet gjithashtu u janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit Lokal (MAPL) konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KUVEND- AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS

Gjatë periudhës janar – dhjetor, Kuvendi Komunal Rahovec ka zhvilluar 11 seanca të rregullta. Në kuadër të këtyre seancave është diskutuar për çështje të ndryshme me gjithsej 101 pika të rendit të ditës. Nga çështjet të cilat janë diskutuar në Kuvend, vërehet që për këtë periudhë dymbëdhjetë mujore kemi disa akte të ndryshme komunale qofshin ato rregullore, vendime, plane, raporte, informata të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna për llojin dhe numrin e akteve komunale që ka miratuar Kuvendi i Komunës nga fushëveprimtaria e vet.

RAPORT I PUNËS (JANAR- DHJETOR) 2021

Siç mund të shihet nga tabela, për periudhën: janar - dhjetor Kuvendi i Komunës ka nxjerrur këso lloj aktesh:

AKTE	NR.
RREGULLORE	5
PLANE	0
VENDIME	40
RAPORTE	11
INFORMATA	12
GJITHSEJ:	68

PUBLIKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në faqen elektronike të Komunës së Rahovecit.

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

Ministria e Pushtetit Lokal është autoritet mbikqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve, andaj gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 të gjitha aktet apo vendimet që janë marr në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, i janë dërguar për shqyrtimin e ligjshmërisë, Ministrisë së Pushtetit Lokal. Numri i Konfirmimit të ligjshmërisë së vendimeve të kthyer nga MAPL-ja është gjithsej 31.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RISHQYRTIMI I AKTEVE LIGJORE TË EVIDENTUARA

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë, Ministria e Pushtetit Lokal ka shqyrtuar të gjitha aktet e miratuara nga ana e Kuvendit Komunal Rahovec, ku gjithsej na janë kthyer 31 konfirmime, dhe është rekomanduar rishikimi i 3 (tre) vendimeve të miratuara. Bazuar në këto rekomandime, vendimet janë rishqyrtuar dhe janë miratuar në përputhje me rekomandimet e MPL-së.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës i Kuvendit Komunal- Rahovec, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në frymën e transparencës, llogaridhënies dhe performances sa më të mirë komunale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Ju faleminderit!

01 Nr. 254/2022

Rahovec: 20.01. 2022

Udhëheqës për punë të Kuvendit


Skender Hamza

